

|                                                                                   |                                    |        |              |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|--------|--------------|
|  | SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT |        | F-042        |
|                                                                                   | Prishtinë                          | v. 2.0 | Faqe 1 nga 4 |

Kodi: 076

## VLERËSIMI PËR TË NXËNË

**Tipi i programit: Themelor**

### Hyrje:

Programi i trajnimit “Vlerësimi për të nxënë” është hartuar nga KEC, më shumë se një dekadë më parë, në kuadër të Programit për Arsimin Themelor (apo BEP, i financuar nga USAID), për të ndihmuar mësime dhënësit e shkollat për të përdorur vlerësimin për të nxënë, si një ndër metodat e vlerësimit të rekomanduara nga reforma arsimore.

Fillimisht, me këtë program janë trajnuar mësime dhënësit e pothuajse të gjitha shkollave fillore dhe të mesme të ulëta. Mësime dhënësit e trajnuar kanë dhënë informata kthyesë shumë të mira lidhur me këtë program trajnimi, dhe me zbatimin e tij është dëshmuar një përmirësim i theksuar i procesit të vlerësimit të vazhdueshëm në klasë.

Më vonë, gjatë periudhës 2019 – 2021, programi është ofruar edhe për mbi 300 mësime dhënësit të gjimnazëve partnere të programit ASSET (programi ASSET ka qenë i financuar nga USAID dhe është zbatuar nga KEC).

Programi “Vlerësimi për të nxënë”, ka për bazë dhe reflekton dokumentet zyrtare të arsimit në Kosovë: Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, Standardet e Vlerësimit, Kodin e Etikës së Vlerësimit, UA (06/2022) për vlerësimin e nxënësve dhe aktivitete të tjera për ngritjen profesionale të mësime dhënësitve.

### Qëllimi i programit dhe rezultatet e pritura:

Qëllimi i këtij programi trajnimi është të mbështesë mësime dhënësit e arsimit parauniversitar në përdorimin e metodave efektive të vlerësimit, me fokus të veçantë në vlerësimin për të nxënë. Programi synon të zgjerojë këndvështrimin e mësime dhënësitve për vlerësimin, duke e trajtuar atë jo si një aktivitet të veçantë që realizohet vetëm në faza të caktuara të orës mësimore apo të vitit shkollor, por si një proces të vazhdueshëm që ndihmon zhvillimin e kompetencave të nxënësve.

Përmes këtij trajnimi, mësime dhënësit do të aftësohen të përdorin strategji dhe teknika të vlerësimit formues, të cilat ndihmojnë nxënësit të reflektojnë mbi të nxënësit e tyre, të përmirësojnë rezultatet mësimore dhe të zhvillojnë aftësi të nevojshme për jetën, punën dhe karrierën e tyre në të ardhmen.

|                                                                                   |                                    |        |              |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|--------|--------------|
|  | SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT |        | F-042        |
|                                                                                   | Prishtinë                          | v. 2.0 | Faqe 2 nga 4 |

Pas përfundimit të programit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë vlerësimin formues nga vlerësimi përmbledhës, duke kuptuar rolin dhe rëndësinë e secilit në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve;
- Shpjegojnë parimet, karakteristikat dhe ciklin e vlerësimit për të nxënë, si qasje që mbështet përparimin e vazhdueshëm të nxënësve;
- Përdorin strategji dhe teknika të vlerësimit formues për të mbështetur zhvillimin e aftësive komunikuese, shqyrtimin e informacionit, planifikimin strategjik dhe të menduarit kritik të nxënësve;
- Zbatojnë vlerësimin formues për zhvillimin dhe vlerësimin e shkathtësive të buta, duke përfshirë bashkëpunimin, komunikimin, përgjegjësinë dhe reflektimin;
- Planifikojnë orë mësimore model që integrojnë vlerësimin për të nxënë, duke përdorur aktivitete, instrumente dhe forma reflektimi që ndihmojnë përmirësimin e rezultateve të nxënësve.

## Përmbajtja

Përmbajtja e programit mbështet nevojën për ngritjen profesionale të mësimdhënësve, duke i orientuar ata drejt planifikimit, zbatimit dhe reflektimit mbi praktikën e vlerësimit që kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave të nxënësve. Temat kryesore që trajtohen përfshijnë:

- Vështrimi i përgjithshëm i punëtorisë;
- Pse duhet të ndryshojmë vlerësimin në klasë;
- Vlerësimi formues dhe vlerësimi përmbledhës;
- Qëllimet e të nxënësve dhe kriteret e suksesit;
- Informatat kthyes;
- Vlerësimi i ndërsjellë;
- Vetëvlerësimi;
- Përdorimi i pyetjeve efektive;
- Planifikimi i mësimin që përfshin vlerësimin për të nxënë.

|                                                                                   |                                    |        |              |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|--------|--------------|
|  | SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT |        | F-042        |
|                                                                                   | Prishtinë                          | v. 2.0 | Faqe 3 nga 4 |

### Grupi i synuar

Programi i trajnimit, në radhë të parë, është konceptuar për t'u ofruar për të gjithë mësime dhënësit e arsimit parauniversitar. Megjithatë, programi mund të ndiqet edhe nga profesionistët tjerë arsimorë në shkollë, që mund të ofrojnë mbështetje për mësime dhënësit, apo drejtpërdrejt për nxënësit, si: mësime dhënësit mbështetës, koordinatorët e cilësisë në shkollë, menaxhmenti i shkollës, etj.

### Forma e organizimit/kohëzgjatja

Programi i trajnimit "Vlerësimi për të nxënë" i ka 24 orë. Programi realizohet në formë të programit treditësh të trajnimit (18 orë), i shoqëruar me mbështetje nga trajnerët gjatë punës së mësime dhënësitve në realizimin e planifikimeve të orëve mësimore ku përfshihet vlerësimi për të nxënë, si dhe në përdorimin e strategjive dhe teknikave të vlerësimit për të nxënë (6 orë).

Forma e organizimit dhe kohëzgjatja është si vijon:

- Ofrimi i dy ditëve të para të trajnimit;
- Planifikimi dhe zbatimi i së paku dy orëve mësimore me përdorim teknikave të vlerësimit për të nxënë, mes ditës së dytë dhe ditës së tretë të trajnimit;
- Ofrimi i ditës së tretë të trajnimit ku pjesëmarrësit prezantojnë përvojën me planifikim dhe zbatim, si dhe marrin informata kthyes nga kolegët dhe trajnerët;

Mësime dhënësit këshillohen ta mirëmbajnë/plotësojnë më tej dosjen e zhvillimit profesional të mësime dhënësitve, si pjesë e praktikës reflektive.

### Vlerësimi/Certifikimi

Pjesëmarrësit certifikohen gjithsej për 24 orë (18 orë trajnimi si dhe 6 orë zhvillimi përmes punës në shkollë).

Kriteret për certifikim janë:

- Pjesëmarrja aktive në trajnim, së paku në 90% të kohëzgjatjes së trajnimit; dhe
- Dokumentimi i planifikimit dhe zbatimit të së paku dy orëve mësimore me përdorim të teknikave të vlerësimit për të nxënë.

|                                                                                   |                                    |        |              |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|--------|--------------|
|  | SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT |        | F-042        |
|                                                                                   | Prishtinë                          | v. 2.0 | Faqe 4 nga 4 |

### **Materiallet e trajnimit**

- Prezantimet në PowerPoint
- Fletët e punës (Shtojcat)
- Doracaku për mësimdhënës – Vlerësimi për të nxënë <https://kec-ks.org/wp-content/uploads/2023/07/Vleresimi-per-te-nxene-Doracak-per-mesimdhenes-2.pdf>